



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 946 / 12 Prot.

Vlorë, më 28 05.2023

VENDIM

Nr. 24, datë 08.05.2023

**PËR
MIRATIMIN RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË
VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, gërma d, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të UV-së, si dhe referuar shkresës së MAS me nr. 1415/2 prot, datë 26.04.2023, propozimin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë me nr.302/3 prot, datë 04.05.2023, shkresës së Drejtorisë së Edukimit për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve me nr. 938/2 prot, datë 08.05.2023, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.05.2023

VENDOSI


1. Të miratojë rregulloren e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën e psiko-pedagogjisë, në Departamentin e Edukimit, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, sipas shkresës nr. 938/2, datë 08.05.2023, (Materiali bashkëlidhur pjesë e këtij vendimi).
2. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Zv/ Rektorit Akademik dhe Departamentit të Edukimit në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë. ✓

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E EDUKIMIT PËR CIKLIN I DHE II TË STUDIMEVE

Nr. 938 | Prot.

Vlorë më, 08.05.2023

2

Lënda: Përcillet për miratim Rregullorja e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në Departamentin e Edukimit, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë.

PROF.DR. ROLAND ZISI
KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Bazuar në Udhëzimin e MAS Nr.3 datë 15.02.2023 " Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlerëshme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndën e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike ", shkresën e MAS me Nr.1415/2 prot datë 26.04.2023 protokolluar prej nesh me Nr.885 prot date 27.04.2023 si dhe shkresat e FSHHD-së me Nr.302 prot datë 04.05.2023, Nr.302/1 prot datë 04.05.2023, Nr.302/2 prot datë 04.05.2023 dhe Nr.302/3 prot datë 04.05.2023, të protokolluara prej nesh me Nr.938 prot datë 05.05.2023 , ju paraqesim për miratim:

Rregulloren e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në Departamentin e Edukimit, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë.

Bashkëlidhur kësaj shkrese:

1. Shkresa Nr.1415/2 prot datë 26.04.2023
2. Shkresa Nr.938 prot datë 05.05.2023

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI

Alberta Breshanaj



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"

ZYRË E KRYEARIT

885

27.04.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

DREJTORIA E POLITIKAVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. 1415 Prot.

Tiranë, më 26.4.2023

Lënda: Dërgohet raporti i grupit të punës, i ngritur me Urdhrin nr. 115, datë 27.02.2023.

UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.3, Tiranë

UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2 Tiranë

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", Tiranë

UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Adresa: Sheshi 2 Prilli 24, Shkodër

UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Adresa: Rruga "Ismail Zyma", Elbasan

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Adresa: Skelë, Rruga Kosova, Vlorë

UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Adresa: Bulevardi "Rilindasit 1", Korçë

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Adresa: Rruga "Studenti 30", Gjirokastrë

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës

Adresa: 14, 2001, Rruga Currila, Durrës

UNIVERSITETIT "ALBANIAN UNIVERSITY"

Adresa: "Bulevardi Zogu I", 1001

UNIVERSITETIT "BARLETI"

Adresa: Rruga "Frang Bardhi", Selitë, Tiranë

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 23, AL 1001, Tiranë website: www.arsimi.gov.al info@arsimi.gov.al

UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS
Adresa: Rruga "Xhanfize Keko", Kompleksi Xhura, Tiranë

UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta.52", Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"
Adresa: Pallati i Sportit "Asllan Rusi", Rr "Dritan Hoxha", Pallatet Komfort,
Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "BEDËR"
Adresa: Kompleksi Usluga, Rruga "Jordan Misja", Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI"
Adresa: Rruga "Taulantet", Kodër-Kamëz, Tiranë


Në zbatim të Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2023 "Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", i ndryshuar, ju dërgojmë, bashkëlidhur, për njohje dhe zbatim raportin e grupit të punës, i ngritur me Urdhrin nr. 115, datë 27.02.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e kurrikulës së programeve të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit nga individë, të cilët zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar".

Afati i aplikimit për hapjen e programeve të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është deri në datën 15.05.2023.

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

RAPORT

I GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E KURRIKULËS SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT NGA INDIVIDË QË ZOTËROJNË DIPLOMA UNIVERSITARE TË NJËVLERSHME, TË NGJASHME OSE TË PËRAFËRTA NË FUSHËN/LËNDËT E MËSIMDHËNIES NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR.

Grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 115, datë 27.2.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit u mbledh në datën 1 mars 2023 në ambientet e FSHS-së, të Universitetit të Tiranës. Objekti i punës së grupit ishte përcaktimi i kurrikulës së certifikatës së programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike. Kjo certifikatë do të mundësojë ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit edhe nga individë të cilët zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme apo të përafërta me fushën/lëndët e mësimeve në arsimin parauniversitar.

Puna e grupit u mbështet:

Së pari, te Ligji nr. 80/2015, datë 17. 09. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”. Pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 81, të këtij ligji, lejon institucionet e arsimit të lartë që të organizojnë programe të formimit të vazhduar.

Së dyti, te Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2023, i MAS-it “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike”. Ky udhëzim shprehet në pikën 1, që profesioni mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diploma universitare që kanë zgjatur së paku me 4 vite akademike deri në përshtatjen e studimeve sipas parimeve të Procesit të Bolonjës, diplomë universitare të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë ose diplomë universitare të integruar të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar. Gjithashtu detyron edhe plotësimin e germës b, që individët që plotësojnë pikën 1, duhet të zotërojnë një certifikatë për formimin në fushën psiko-pedagogjike, të lëshuar nga insitucionet e arsimit të lartë që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar në fushën e mësuesisë.

Së treti, te dokumentacioni zyrtar i dakordësuar dhe i dorëzuar në MAS dhe ASCAP, nga produkti i takimit kombëtar të datës 11.11.2022 me të gjithë përfaqësuesit e IAL publike. Ky material i dakordësuar me përfaqësues nga të gjitha IAL publike,

përfshinte njehsimin në masën mbi 80 % të kurrikulës së formimit psiko-pedagogjike në programet master të mësuesisë, në IAL publike dhe IAL me status të Veçantë si Artet e Sportet. Produkti i prodhuar nga IAL publike njehsoi kurrikulën e formimit psiko-pedagogjik mes gjithë IAL-ve publike, konform kërkesës që ka, ligji nr. 80/2015 dhe të bazuar më tej edhe në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, dhe në Urdhrin e Ministrit të Arsimit nr.225, datë 07.05.2018 “Për përafimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë të institucioneve të arsimit të lartë”.

Së katërti, të diskutimet efektive të anëtarëve të grupit të punës. Produkti përfundimtar i diskutimeve nga grupi i punës ishte prodhimi i një materiali unifikues në masën mbi 80% të kurrikulës së Certifikatës së Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-pedagogjike, duke u dakordësuar për modulet/lëndët që do të ishin të njëjta dhe modulet/lëndët që do të ishin të ndryshme sipas specifikave të secilës IAL dhe sipas specifikave të statusit të IAL-ve.

Grupi i punës, duke shfrytëzuar të gjitha këto burime, arriti dakordësinë duke hartuar kurrikulën e programit të formimit të vazhduar “Certifikatë Për Formimin Psikopedagogjik” për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit nga individë të cilët zotërojnë diploma universitare të njëvlershme, të ngjashme apo ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar.

Plani mësimor, i hartuar dhe i titulluar me emrin “Çertifikatë Për Formimin Psikopedagogjik” përmbush parametrat që kërkon Udhëzimi Nr. 3, datë 15.02.2023, i ndryshuar se:

- “Çertifikata Për Formimin Psikopedagogjik” ka bashkë me provën finale 35 kredite, pra, ka jo më pak se 30 kredite
- “Çertifikata Për Formimin Psikopedagogjik” realizohet për një semestër, konform kërkesës së Udhëzimit Nr 3 .
- Kurikula e “Çertifikatës Për Formimin Psiko-Pedagogjik” është e unifikuar në masën mbi 80 % mes IAL-ve publike, IAL-ve Jo Publike dhe IAL-ve me status të veçantë, duke ju përgjigjur nenit 83, pika 4, të LAL 80/2015.
- Kurikula e “Çertifikatës Për Formimin Psiko-Pedagogjik” lejon ndryshueshmëri mes IAL-ve aplikuese deri në masën e lejuar 20 % . Kurikula e hartuar dhe e dakordësuar nga të gjitha IAL publike, IAL Jo -Publike dhe IAL me status të veçantë, ka 5 module/lëndë të unifikuara të formimit të fushës psiko-pedagogjike dhe 1 modul/lëndë të ndryshme për secilën IAL sipas specifikave të tyre përkatëse.
- Hartimi i syllabuseve të moduleve/lëndë është e drejtë dhe përgjegjësi e IAL-ve që e implementojnë këtë program të formimit të vazhduar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEKANI

Nr. 302/3 Prot.

Vlorë, më 04.10.2023

Lënda: Përcjellje e rregullore së programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, Departamenti i Edukimit.

**PROF. DR. ROLAND ZISI, REKTOR, UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI",
VLORE**

I nderuar Z. Rektor,

Bazuar në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2023 të MAS-it "Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", shkresën me nr. 1415/2, datë 26.04.2023, në funksion të përgatitjes së dokumentacionit për aplikim, bashkëlidhur përcjellim rregullorën e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psikopedagogjike për miratim nga Senati Akademik.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

Prof. As. Armiela Panajoti
Në mungesë dhe me Urdhër

Dr. Oljana Hoxhaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Nr. 302/ prot.
2

Vlorë, më 04.05.2023

Lënda: Përcjellje për miratimin e rregullores së Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike në Senatin Akademik.

PROF. AS. DR. ARMELA PANAJOTI, DEKANE E FSHHD-së

Këtu

Mbështetur në nenin 25 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë," VKM nr. 41, datë 24.01.2018, Rregulloren e UV, neni 61 'Programet e studimit me karakter profesional', Departamenti i Edukimit, në mbledhjen e radhës, datë 05.05.2023, miratoi në mënyrë unanime rregulloren e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike. Bazuar në procedurat dhe legjislacionin në fuqi, kërkojmë përcjelljen e këtij vendimi për miratim të mëtejshëm nga Senati Akademik. Bashkëlidhur rregullorja e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

PËRGJEGJËS DEPARTAMENTI

PhD. Ilva Lamaj

Adresa /Adress: L. Hajrro Cakërrri, Rr. Sulejman Delvina, Vlorë, Albania
Tel. Fax ++35533224952

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

**“RREGULLORE E
PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT
TË VAZHDUAR NË FUSHËN
PSIKO-PEDAGOGJIKE PËR USHTRIMIN E
PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË
MËSUESIT”**

Tiranë, 2023

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Baza ligjore e Rregullores së Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit, është:

Ligji Nr. 80 datë 17.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 81 i këtij ligji në, pikat 1, 2, 3 që lejon institucionet e arsimit të lartë për të zhvilluar programe të formimit të vazhduar.

Udhëzimin Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike"

Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Rregullorja e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Aktet e brendshme rregullatore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 2

Objekti i Rregullores

Kjo Rregullore vendos rregullat normative për organizimin dhe funksionimin e "Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit" dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në zhvillimin e këtij programi. Rregullorja përcakton misionin e studimit dhe të kualifikimit, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve; rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për vlerësimin, për certifikimin dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullave.

Neni 3

Përmbajtja Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike

Plani mësimor përmban 6 module/lëndë të formimit psiko-pedagogjik, nga të cilat 5 module/lëndë bazë, dhe 1 modul /lëndë opsionale me zgjedhje nga module sipas specifikave të seciles IAL si dhe provën finale.

Qëllimi i përgjithshëm i programit të formimit është që studentët të fitojnë një sfond të gjerë dhe të qëndrueshëm shkencor, si dhe kompetenca që lidhen me formimin psiko-pedagogjik në aspektin teorik dhe atë praktik, që u mundëson ushtrimin e profesionit të mësuesisë, sipas fushës përkatëse të studentit në formimin e mëparshëm universitar.

KREU II ORGANIZIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Neni 4 Organizimi administrativ

4.1. Përgjegjësinë për organizimin e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit e ka Departamenti i Edukimit.

Neni 5 Koordinimi dhe këshillimi

5.1. Departamenti i Edukimit ka koordinatorin për programin, i cili mban lidhjet me Departamentin dhe Fakultetin. Koordinatori koordinon aktivitetet rreth organizmit, menaxhimit dhe zhvillimit të programit, si dhe këshillon studentët në lidhje me studimet.

5.2. Stafi akademik i programit i këshillon studentët në lidhje me lëndët përkatëse.

Neni 6 Programi i studimit vazhduar

Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar ofron një formim të specializuar në fushën psiko-pedagogjike dhe drejton studentin drejt specializimit të profesionit të mësuesisë. Ai realizohet me:

- 35 kredite;
- ofrohet me kohë të plotë.

Neni 7 Afati dhe e drejta e studimeve

7.1. Kohëzgjatja normale e studimit për Programin e Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike me 35 kredite është 4, 5 muaj ose 1 (një) semestër akademik.

Neni 8 Politika e regjistrimit dhe frekuentimit

8.1. Në këtë Program regjistrohen ata kandidatë që kanë mbaruar studimet universitare konform ankesit 1. të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike"

8.2 Kanë diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave, Master i Arteve ose master profesional me 120 kredite apo ekuivalente me to, të lëshuara nga insitucione të arsimit të lartë, programi i studimit të së cilave përputhet me një nga fushat / Lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar të përcaktuar në aneksin 1 të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS

8.3. Kanë mesataren e maturës shtetëror që lejon studime bachelor në mësuesi, sipas ligjeve në fuqi.

8.4. Frekuentimi i studentëve është i detyrueshëm për të gjitha modulet/lëndët mësimore dhe provën finale.

8.5. Pjesëmarrja në orët mësimore në auditor është e detyrueshme për të marrë kreditet e përcaktuara për modulet/lëndët.

8.6. Mungesa në mësim në programet me kohë të plotë është e pranuar deri në masën 20% të orëve mësimore të parashikuara në auditor.

Neni 9

Procedura për frekuentimin

- 9.1. Pedagogët duhet të mbajnë shënime për frekuentimin e studentëve.
- 9.2. Pedagogët duhet të njoftojnë studentët për pasojat e mungesave në vlerësim.
- 9.3. Studenti që mungon duhet të njoftojë pedagogun e lëndës.
- 9.4. Pedagogu i lëndës plotëson skedën e krediteve të lëndës për secilin student të cilën studentit e paraqet në sekretarinë mësimore për t'u regjistruar në provim.

Neni 10

Struktura e studimeve

1. Cikli i studimit: Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike
2. Emërtimi i Certifikatës: "Certifikatë e Programit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike"
3. Kohëzgjatja e Programit të Studimit të Vazhduar dhe Kualifikimit: 4,5 muaj (1 semester)
4. ECTS total: 35 ECTS
5. Forma e zhvillimit të programit: Me kohë të plotë

Neni 11

Plani mësimor

- 11.1. Plani mësimor përbëhet nga 5 lëndë mësimore bazë, 1 lëndë opsionale nga një numër lëndësh që vendosen sipas specifikave të secilës IAL dhe provën finale. Plani mësimor ndërtohet me lëndë të formimit të domosdoshëm psiko-pedagogjike, konform materialit të dakordësuar dhe miratuar nga Grupi i Punës i Urdhëruar nga MAS me Urdhër Nr.115, datë 27.02.2023.

11.2. Plani mësimor miratohet me vendim të Senatit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë

Neni 12 **Programi i lëndës**

12.1. Programi i lëndës hartohet dhe nënshkruhet nga titullari i saj, sipas formatit standard të miratuar nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe konform VKM Nr. 41, datë 22.2.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

12.3. Programet e lëndëve depozitohen në Departament.

Neni 13 **Format e mësimimit**

13.1. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, diskutimeve, debatit, punës në grupe, studimit të rastit, simulimeve, prezantimeve, praktikës.

13.2. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 minuta.

13.3. Veprimtaria mësimore e programit zhvillohet në gjuhën shqipe.

Neni 14 **Praktika**

Komponenti i praktikës zhvillohet pas përfundimit të këtij programi dhe menaxhohet nga institucionet e arsimit parauniversitar në varësi të Zyrave Arsimore Vendore, ku ka vendbanimin studenti, me një afat kohor konform ligjeve në fuqi, që adresojnë licensimin e profesionit të mësuesisë dhe është objekt monitorimi dhe vlerësimi nga ZVA-të.

KREU III

VLERËSIMI I STUDENTIT

Neni 15 **Kritere dhe procedura të vlerësimit**

15.1. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të njohura studentëve në fillim të tyre.

15.2. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte, ese; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.

15.3. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në përfundim të saj.

15.4. Notat vendosen në bazë të pikëve.

15.5. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash.

15.6. Vlerësimi kryhet sipas sistemit të detajuar më poshtë:

Shkalla e pikëve	Nota numerike	Përshkrimi i notës	Nota shkronja me
96 – 100	10	Shkëlqyeshëm	A+
86- 95	9	Shumë mirë	A
76-85	8	Mirë	B+
66-75	7	Kënaqshëm	B
56 – 65	6	Mjaftueshëm	C
50 – 55	5	Kalueshëm	D
≤49	4	Mbetës	FX
	3, 2, 1	Mbetës	F
		E papërfunduar*	
		Nuk ka të dhëna**	

*E papërfunduar

Një notë e papërfunduar mund t'i shënohet një studenti në qoftë se ai nuk i ka përmbyshur të gjitha kërkesat e lëndës deri në fund të semestrit, por ka kryer një sasi të konsiderueshme të punës. Është përgjegjësi e studentit të njoftojë pedagogun dhe të arrijë një marrëveshje për plotësimin e pjesës tjetër të modulit/lëndës. Në qoftë se kërkesat nuk plotësohen brenda një viti, atëherë automatikisht shënohet notë pakaluese.

*** Nuk ka të dhëna për notën

Ky shënim do të vendoset në pasqyrën e rezultateve të studentit në atë rast kur studentin është regjistruar për modulin/lëndën dhe nuk është shënuar asnjë notë nga pedagogu. Kjo nuk ka efekt në mesataren e studentit dhe mund të shndërrohet në notë numerike dhe me shkronjë, atëherë kur pedagogu vendos notën në procesverbal.

Neni 16

E drejta për të hyrë në provim

16.1. Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur ka shlyer detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor/programin lëndor dhe kur ka marrë skedën e krediteve për frekuentimin e lëndës, të firmosur nga pedagogu i lëndës.

16.2. Studenti nuk mund të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në lëndë të ndryshme.

16.3. Studenti mbetës ka të drejtë të riprovohet edhe dy herë të tjera.

Neni 17

Zhvillimi i provimeve

17.1. Provimet zhvillohen në përfundim të kursit, duke përcaktuar një sezon 2 javor për përfundimin e tyre

17.2. Provimet dhe riprovimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik.

17.3. Në rast pamundësie të jashtëzakonshme të zhvillimit të provimit ose të prezantimit ditën e caktuar, përgjegjësi i departamentit me urdhër me shkrim, cakton një datë tjetër të mëvonshme e cila u bëhet e njohur studentëve dhe pedagogëve.

17.4. Provimet vlerësohen nga pedagogu/pedagogët që kanë zhvilluar lëndën. Në raste të veçanta departamenti cakton një komision tjetër.

Neni 18

Riprovimi

18.1. Riprovimi në një lëndë të caktuar kryhet dy javë pas provimit të dhënë më parë.

Neni 19

Komunikimi i vlerësimeve

19.1. Vlerësimet për provimet komunikohen nga Sekretaria mësimore.

Neni 20

Dokumentimi i vlerësimeve

20.1. Vlerësimet dokumentohen në Fletën e vlerësimit dhe në Regjistrin e rezultateve akademike.

20.2. Fleta e vlerësimit plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 5 ditë nga dita e provimit ose e prezantimit të detyrës së kursit. Fleta e vlerësimit firmoset nga përgjegjësi i departamentit dhe kryesekretari.

20.3. Në asnjë rast Fleta e vlerësimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtojë emra në të.

KREU IV

CERTIFIKIMI

Neni 21

Procedura e Certifikimit

21.1. Certifikimi i studenti bëhet pasi ai/ajo ka shlyer të gjitha provimet e lëndëve sipas planit mësimor, si dhe provën finale.

21.2. Certifikata nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit.

Neni 22

Marrja e certifikatës

22.1. Tërheqja e certifikatës bëhet personalisht nga student i certifikuar, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin e diplomave/certifikatave.

KREU V

PRANIMI I STUDENTËVE

Neni 23

Politika dhe kriteret e pranimit

23.1. Pranimi i kandidatëve bëhet me aplikim të studentëve. Kandidati aplikues duhet të zotërojë një diplomë të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor që të jetë në fushë lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë konform ankesit 1., të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike"

23.2 Kandidati duhet të ketë edhe Diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave, Master i Arteve ose master profesional me 120 kredite, apo ekuivalente me to, të lëshuara nga insitucione të arsimit të lartë, programi i studimit të së cilave përputhet me një nga fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar të përcaktuar në aneksin 11 të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS

23.2.Për aplikanët që kanë fituar diplomë/diploma studimi jashtë vendit duhet të kenë ekuivalentuar studimet e tyre në institucionet përgjegjëse në Shqipëri, por dhe që janë konform kërkesave të pikës 23.1.

Neni 24

Dokumentacioni i pranimit

- a) Formulari i plotësuar i kërkesës.
- b) Fotokopje e kartës së identitetit.
- c) Biografi profesionale.
- d) Diploma e maturës, diplomat e studimeve të larta universtare (bachelor, master shkencore, diplomë e studimeve të integruara), sipas kriterëve të parashtruara në pikën 8.1 dhe 8.2
- e) 2 fotografi me format pasaporte.
- f) Fletëpagesa e tarifës së regjistrimit.

Neni 25

Informacioni për kriteret dhe procedurat e pranimit

Informacioni për kriteret dhe procedurat e pranimit publikohet:

- në faqen e Internetit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- në medien e shkruar dhe elektronike;
- në paketën e informacionit të studimeve të vazhduara që ofron Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

KREU VI

STUDENTËT

Neni 26

Të drejtat e studentëve

Studentët kanë këto të drejta:

- a. Të udhëhiqen nga rregulla dhe procedura të formuluar qartë dhe të justifikuara në aspektin akademik.
- b. Të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji ose nga ndonjë kriter i papërshtatshëm i vlerësimit akademik.
- c. Të kenë në dispozicion të gjithë informacionin që u takon të kenë për të gjitha çështjet akademike dhe veprimtarinë e shkollës.
- d. Të përdorin pajisjet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, sipas rregullave përkatëse për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tyre shkencor, bibliotekën dhe Internetin;
- e. Të paraqesin pikëpamjet e tyre pa frikë nga ndëshkimi.
- f. Të përfaqësohen në organet drejtuese të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- g. Të refuzojnë të kryejnë detyra që nuk lidhen me zhvillimin profesional.

Neni 27

Përgjegjësitë e studentëve

Studentët kanë këto përgjegjësi:

Të njohin dhe të zbatojnë Rregulloren e "Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit", kërkesat e programit të studimit dhe të jenë të vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.

- a. Të sillen në një mënyrë profesionale dhe qytetare në tërë ndërveprimet në institucion me drejtuesit, personelin akademik dhe administrativ, studentët e tjerë dhe bashkëpunëtorët e departamentit.
- b. Të përmbushin në kohë të gjitha kërkesat dhe detyrimet e programeve lëndore dhe të praktikës.
- c. Të respektojnë kohën e pedagogëve.

- d. Të paguajnë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e studimit në afatet e caktuara.
- e. Të mbajnë përgjegjësi për shkeljet e rregullave Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë nga ana e tyre.

Neni 28
Përgjegjësitë e Departamentit të Edukimit

- a) Departamenti i jep studentëve gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me Rregulloren, politikën e zhvillimit të programit, kriteret e pranimit, planin dhe programet lëndore, rregullat e vlerësimit, rregullat e certifikimit, rregullat financiare.
- b) Respekton të gjitha kriteret profesionale, shkencore dhe pedagogjike për mësimdhënien, praktikën, vlerësimin.
- c) Asiston studentët në plotësimin e kërkesave që lidhen me zbatimin e programit të studimit.
- d) Krijon kushtet e përshtatshme për realizimin e programit (siguron mjediset, rrjetin e informacionit, vë në dispozicion bibliotekën, mjete mësimore dhe teknologjinë elektronike).

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29

- 29.1. Kjo rregullore mund të përmirësohet ose të korrigjohet gjatë punës pjesërisht ose tërësisht nga Departamenti i Edukimit.
- 29.2. Një kopje e kësaj rregulloreje depozitohet në protokollin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- 29.3. Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Zyra Juridike e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Tiranë, Mars 2023

Përgjegjës i Departamentit të Edukimit
PhD. Ilva Lamaj

.....




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEKANI

Nr. 302/1 Prot.

Vlorë, më 04.10.2023

Lënda: Përcjellje e propozimit të Departamentit të Edukimit për çeljen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike.

PROF. DR. ROLAND ZISI, REKTOR, UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI",
VLORE

I nderuar Z. Rektor,

Bazuar në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2023 të MAS-it "Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", shkresën me nr. 1415/2, datë 26.04.2023, bashkëlidhur përcjellim propozimin e Departamentit të Edukimit për çeljen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike për miratim nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEKANI
Prof. As. Armela Panajoti
Në mungesë dhe me Urdhër
ZVDEKAN

Dr. Oljana Hoxhaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Nr. 322... Prot.

Vlorë, më 04.05.2023

Lënda: Përcjellje e propozimit për hapjen e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike në Senatin Akademik.

Prof. Asoc. Dr. Armela Panajoti: Dekan i Fakultetit të Shkencave Humane

Referuar Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 75, pika 6, pas daljes së akteve nënligjore, Udhëzimit Nr. 31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", Kreu 3, pika 2-f, si dhe Vendimittë Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", shtojca Nr. 1, Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlefshme të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.

Grupi i punës pasi shqyrtoi kurrikulën e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike, propozoi hapjen e këtij programi pranë Departamentit të Edukimit të Universiteti "Ismail Qemali".

Bashkangjitur po ju përcjellim propozimin për hapjen e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.

Përgjegjësi i Departamentit të Edukimit
PhD. Ilva Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Nr. Prot.

Vlorë, më 04.05.2023

Lënda: Përcjellje e propozimit për hapjen e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.

PhD. Ilva Lamaj: Përgjegjësi i Departamentit të Edukimit PhD. Ilva Lamaj

Referuar Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 75, pika 6, pas daljes së akteve nënligjore, Udhëzimit Nr. 31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", Kreu 3, pika 2-f, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", shtojca Nr. 1, Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlefshme të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.

Grupi i punës pasi shqyrtoi kurrikulën e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike, propozoi hapjen e këtij programi pranë Departamentit të Edukimit Universiteti "Ismael Qemali".

Bashkangjitur po ju përcjellim propozimin për hapjen e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.

PhD Ilva Lamaj

Dr. Erjona Dervishaj

Dr. Petrit Taraj

Dr. Arbana Zhapaj

Dr. Gentiana Xhelili

Plani Mësimor "Certifikatë Për Formimin Psikopedagogjik"

N r	Emertimi Lendes	Kredit e	Ore Gjithse j	Ore leksion e	Ore seminar e	Ore praktik e	Orë jashte Auditor it	Ngarkes a javore
1	Zhvillimi Kurrikules • Moduli Kurikula • Moduli Arsimi gjithperfshires	5	125	30	30		65	2/2
2	Metodologji e mësimdhënies dhe të nxënit • Moduli Metodot e mesimdhënies • Moduli Mendimi kritik • Moduli Të nxënit	7	175	60	30		85	4/2
3	Vlerësimi i të nxënit	6	150	30	30		90	2/2
4	Psikologji Zhvillimi dhe Edukimi • Moduli	6	150	60	15		75	4/1

	Psikologji Zhvillimi • Moduli Psikologji Edukimi							
5	Menaxhimi Klasës	3	75	15	15		45	1/1
6	Lëndë me zgjedhje Shkrim Akademik/ Didaktika e Gjuhës së Huaj/Didaktikës Shkencave(STE M)	3	75	15	15		45	1/1
7	Prova Finale	5	125				125	
	TOTALI	35	875	210	135		530	



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

ZYRA E DEKANIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NR. 938

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE DATA 05.05.2023
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË
DEKANI

Nr. 302/5 Prot.

Vlorë, më 04.10.2023

Lënda: Përcjellje e propozimit të tarifës së studimit të programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psikopedagogjike, Departamentit i Edukimit.

**PROF. DR. ROLAND ZISI, REKTOR, UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI",
VLORE**

I nderuar Z. Rektor,

Bazuar në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2023 të MAS-it "Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", shkresën me nr. 1415/2, datë 26.04.2023, bashkëlidhur përcjellim propozimin e tarifës së studimit të programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, Departamentit i Edukimit, për miratim nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

DEKAN

Prof. As. Armela Panajoti
Në mungesë dhe me Urdhër
ZY/DEKAN
VLORE
Dr. Oljana Hoxhaj